



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)** sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 6, paragrafi 6 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 10.07.2024, merr këtë:

**VENDIM**

**Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK**

- I. Subjektit politik GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 6, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Nëse subjekti politik GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme

**Arsyetim**

Subjekti politike GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, është subjekt politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës sipas rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 950/2021 të datës 13 mars 2021. Ky subjekt politik përfiton mjete financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në përputhje me nenin 9 të LFSP.

Subjekti politik si subjekt që përfiton nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, është i obliguar që të publikojë raportin vjetor financiar në përputhje me kërkesat e nenit 19/A të LFSP

Subjekti politik, me datën 20.07.2023, përmes e-mailit, është njoftuar në lidhje me kërkesat ligjore që rrjedhin nga neni 19/A i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Gjithashtu, njoftimi i njëjtë, është dërguar përsëri përmes e-mailit, me datën 26.01.2024.

Subjekti politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore për publikimin e raportit vjetor financiar 2023, siç përcaktohet në nenin 19/A të LFSP. Pas gjetjes së auditorit, ku është konstatuar mos publikimi, Zyra i shqipton gjobën në vlerë katër (4,000) mijë euro, në përputhje me nënparagrafin 6, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik GRAĐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike në shumë e gjobës së shqiptuar.

**Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

Prishtinë, 10.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik GRAĐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik GRAĐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK.

**Këshilla juridike:** Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



KANCELARIJA ZA REGISTRACIJU, POTVRĐIVANJE I FINANSIJSKU KONTROLU  
POLITIČKIH SUBJEKATA (Kancelarija) PRI CENTRALNOJ IZBORNOJ KOMISIJI  
(CIK) na osnovu ovlašćenja definisanih stavom 1. člana 21. i u skladu sa podstavom 6. stav 6.  
Zakona o finansiranju političkih subjekata (ZFPS), dana 10.07.2024, donosi:

## ODLUKA

### O izricanju novčane kazne političkom subjektu GRAĐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK

- I. Političkom subjektu GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK izriče se novčana kazna u iznosu od četiri hiljade (4.000) evra za prekršaj iz podstava 6. stav 6. člana 21. ZFPS.
- II. Politički subjekat GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, dužan je da uplati iznos izrečene novčane kazne prema tački I ove odluke u roku od trideset (30) dana od dana prijema ove odluke i dostavi Kancelariji kopiju uplatnice plaćene novčane kazne.
- III. Ukoliko politički subjekat GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK ne plati novčanu kaznu u roku od trideset (30) dana od dana prijema odluke Kancelarije, novčana sredstva Fonda za podršku političkim subjektima u visini izrečene novčane kazne ne prenose se političkom subjektu.
- IV. Odluke Kancelarije o izricanju novčanih kazni stupaju na snagu danom potpisivanja i konačne su i izvršne.

### Obrazloženje

Politički subjekat GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK je politički subjekat zastupljen u Skupštini Kosova prema rezultatima izbora za Skupštinu Kosova potvrđenim od strane Centralne izborne komisije odlukom br. 950/2021 od 13.03.2021. godine. Ovaj politički subjekat dobija finansijska sredstva iz Fonda za podršku političkim subjektima, u skladu sa članom 9. ZFPS.

Politički subjekat, kao korisnik Fonda za podršku političkim subjektima, dužan je da objavi godišnji finansijski izveštaj u skladu sa zahtevima člana 19/A ZFPS.

Politički subjekat je dana 20.07.2023. godine putem elektronske pošte obavešten o zakonskim uslovima koji proizlaze iz člana 19/A Zakona o finansiranju političkih subjekata. Takođe, ponovo je poslato isto obaveštenje putem elektronske pošte, dana 26.01.2024. godine.

Politički subjekat nije poštovao zakonske uslove za objavljivanje godišnjeg finansijskog izveštaja za 2023. godinu, kako je definisano u članu 19/A ZFPS. Nakon nalaza revizora, gde je utvrđeno neobjavljivanje, Kancelarija izriče novčanu kaznu u iznosu od četiri (4.000) hiljade evra, u skladu sa podstavom 6. stav 6. člana 21. ZFPS.

Politički subjekat GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK dužan je da izvrši uplatu u roku od trideset (30) dana, od dana prijema odluke o izricanju novčane kazne putem službene elektronske komunikacije. Uplata novčane kazne se mora dokazati dostavljanjem kopije uplatnice Kancelariji. U slučaju neplaćanja novčane kazne u roku iz tačke II ove odluke, novčana sredstva Fonda za podršku političkim subjektima u visini izrečene novčane kazne ne prenose se političkom subjektu.

**Iz gore navedenog, Kancelarija odlučuje da izriče novčanu kaznu u iznosu od četiri hiljade (4.000) evra, shodno odredbi ove odluke.**

Priština, 10.07.2024

Direktor Kancelarije



Besnik Buzhala



Odluku dostaviti:

- Predsedniku političkog subjekta GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK
- Ovlašćenom finansijskom predstavniku političkog subjekta GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK.

**Pravni savet:** Protiv odluke Kancelarije za izricanje novčane kazne politički subjekt može pokrenuti tužbu pred nadležnim prvostepenim sudom u roku od trideset (30) dana od dana obaveštenja o odluci. Pokretanje tužbe ne zaustavlja izvršenje ove odluke.